



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2/507

Datë: 12/9/2017

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" bazuar në propozimin e Këshillit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, përkatësisht nenit 87, pika 2 dhe 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më, 07.9.2017, mori këtë:

**V E N D I M**


- I. Miratohet Rregullorja për Studime themelore në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës, "Hasan Prishtina".
- II. Pjesë përbërës e këtij vendimi do të jetë edhe Rregullorja për Studime bachelor në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**A r s y e t i m**

Duke pasur parasysh domosdoshmërinë për hartimin e një Rregullore e cila përcakton kriteret unike për organizimin dhe llojet e studimeve bachelor, kushtet e regjistrimit në studime bachelor, shkollimin e të rinjve në fushën e Edukimit Fizik dhe Sportit, në nivelet e arsimit të lartë, me qëllim që të jenë në gjendje t'i përgjigjen kërkesave të tregut të punës në vend e më gjerë, t'i përshtaten edukimit të vazhdueshëm në këtë fushë shumë dinamike, si dhe të kontribuojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm teknologjik, social dhe shkencor të Kosovës dhe më gjerë, si dhe çështjet tjera të rëndësishme për studimet bachelor në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, prandaj mbi këtë bazë, Senati i UP-së, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1. Arkivit të UP-së
2. Komisionit të Studimeve;
3. Dekanatit të FEFS-së;
4. Sekretarit të Përgjithshëm të UP;
5. Zyrtarit Ligjor të UP-së.



Senati i Universitetit të Prishtinës

Prof. dr. Marjan DEMA - Kryesues



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/507  
Datë: 12/9/2017

Në mbështetje të nenit 48 paragrafi 1.9, nenit 109 paragrafit 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina, dhe me propozimin e Këshillit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, bazuar në nenin 87, pika 2 dhe 3, të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e datës, 07.9.2017 miraton:

## RREGULLORE PËR STUDIMET THEMELORE BACHELOR

### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret unike për organizimin dhe llojet e studimeve, kushtet e regjistrimit në studime, kushtet e regjistrimit të vitit akademik, kohëzgjatja e studimeve, ndërrimi i programit të studimeve, si dhe çështjet e tjera të rëndësishme për studimet bachelor në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit.

### Organizimi dhe llojet e studimeve

#### Neni 2

Studimet bachelor në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit organizohen në katër (4) vite dhe në kuadër të këtyre studimeve, studentit i kërkohet të arrij 240 ECTS.

#### Neni 3

Studimet bachelor organizohet sipas plan - programit mësimor të akredituar nga Këshilli Shtetëror për Cilësi (Agjencioni i Akreditimit të Kosovës).

#### Neni 4

Studentët njoftohen me kohë përmes web faqes me: strukturën e programit studimor, orarin e mësimit dhe provimeve, të cilat do të shpallen në fillim të vitit akademik në përputhje me Statutin e UP-së.

2. Orari i mësimit dhe provimeve nuk mund të ndryshohet pa aprovimin paraprak të Prodekanit për mësim.

#### **Neni 5**

1. Mësimdhënësit janë të obliguar që në fillim të vitit të ri akademik t'i njoftojnë studentët me syllabuset e lëndëve si dhe t'ju sigurojnë së paku dy orare me kohëzgjatje një orë për konsultime.

2. Oraret e konsultimeve duhet të jenë të shpallura në derën e kabinetit të mësimdhënësit.

3. Mësimdhënësit janë të obliguar të mbajnë mësimin sipas dispozitave të Statutit, rregulloreve të veçanta dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.

#### **Kushtet e regjistrimit në studime**

#### **Neni 6**

Kushtet e regjistrimit dhe numri i studentëve të rinj për program studimor, kriteret e pranimit përkatësisht regjistrimit, dinamikën e rrjedhës së procesit, provimin pranues, shpalljen e rezultatit preliminar, ankesat dhe shpalljen e rezultatit final në mënyrë të hollësishme përcaktohen me konkurs publik i shpallur nga ana e Senatit të UP-së.

#### **Neni 7**

1. Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të pranimit të studentëve të rinj, Dekani emëron komisionet përkatëse. Me këtë rast, asnjëri anëtar nuk mund të jetë i emëruar njëkohësisht në dy komisione.

2. Përgjegjësitë dhe obligimet më të hollësishme të komisioneve me propozim të Dekanit i përcakton Këshilli i Fakultetit.

#### **Neni 8**

1. Përzgjedhja e studentëve të rinj të pranuar në vitin e parë, përkatësisht përpilimi i listës preliminare bëhet në bazë të konkursit.

2. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të paraqesin ankesë pas publikimit të listave preliminare sipas kohës së përcaktuar me konkurs,

3. Pas shqyrtimit të ankesave nga komisioni i ankesave, Komisioni Qendror i Fakultetit përpilon listën përfundimtare dhe përmbillet procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për afatin e caktuar.

4. Lista preliminare dhe lista përfundimtare bëhen publike në web faqe të Fakultetit.

#### **Kushtet e regjistrimit të vitit**

#### **Neni 9**

1. Senati i Universitetit të Prishtinës me vendim të veçantë përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studentëve.
2. Pagesat për studimet bachelor do të bëhen në bazë të udhëzimeve administrative të MASHT-it dhe vendimeve të Këshillit Drejtues të UP-së.

#### **Neni 10**

1. Studenti e fillon vitin e ri akademik duke u regjistruar në semestrin dimëror.
2. Studenti i rregullt mund ta regjistroj semestrin veror, vetëm pasi ta ketë regjistruar paraprakisht atë dimëror.
3. Gjatë regjistrimit të secilit semestër, përkatësisht në fillim të semestrit, në përputhje me programin studimor studentit zgjedh lëndët zgjedhore të cilat nuk mund të ndryshohen pas zgjedhjes.
4. Studenti nuk mund t'i nënshtrohet provimeve në afatin e janarit, pa e regjistruar semestrin dimëror, kurse në afatin e qershorit pa e regjistruar semestrin veror.
5. Studenti nuk mund t'i nënshtrohet provimeve të vitit aktual të studimeve para se t'i përfundoj ato të vitit paraprak.
6. Ndaj studentit i cili i nënshtrohet provimeve të vitit aktual pa i përfunduar ato të vitit paraprak, do të merren masa në përputhje me rregulloren për procedurë disiplinore.
7. Studenti i cili nuk i plotëson kushtet për regjistrim në vitin vijues akademik, është i obliguar që të përsëris regjistrimin e vitit të njëjtë të studimeve.
8. Afati i regjistrimit të semestrit përcaktohet me programin studimor, përkatësisht me vendim të Këshillit të Fakultetit.

#### **Neni 11**

1. Vijimi i rregullt i procesit mësimor dhe kryerja e obligimeve të tjera të parapara me programin e studimeve në lëndën e caktuar konfirmohet në fund të semestrit në sistemin elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS).
2. Konfirmimi mbi kryerjen e obligimeve merret, nëse ndryshe nuk është përcaktuar me programin e studimeve ose vendimin e Këshillit, kur vërtetohet se studentit ka qenë i pranishëm së paku 75% të orëve të ligjëratave dhe të ushtrimeve.

#### **Neni 12**

1. Studenti është i detyruar ta bëjë regjistrimin e të dy semestrave (dimëror dhe veror) gjatë një viti akademik.

2. Studenti mund ta regjistrojë semestrin veror, vetëm pasi ta ketë vërtetuar semestrin dimëror.
3. Studentit i vërtetohet semestri vetëm atëherë kur t'i ketë kryer obligimet e parapara në secilën lëndë sipas programit të studimit.
4. Vërtetimi dhe regjistrimi i semestrave kryhet nga Zyra e shërbimit të studentëve BA, Brenda afatit të publikuar në tabelën e shpalljeve dhe në uebfaqen zyrtare të fakultetit.

### **Mobiliteti, vazhdimi i studimeve, ndërrimi i drejtimit dhe njohja e provimeve**

#### **Neni 13**

1. Mobiliteti i studentëve dhe ndërrimi i programit studimor është përcaktuar me Statutin e UP-së, nenet, 142, 143 dhe 155.
2. Vendimi për njohje të notës dhe ECTS pikëve të fituara nga mobiliteti i studentit merret nga Komisioni i Studimeve në përputhje me Statutin e UP-së dhe rregulloret përkatëse për mobilitet.

#### **Neni 14**

Ndërrimi i programeve të studimeve përcaktohet me dispozitat e statutit.

#### **Neni 15**

Këshilli i Fakultetit nxjerr vendim për vazhdim të studimeve, lidhur me kërkesën e studentëve siç përcaktohet me dispozitat e Statutit.

#### **Neni 16**

1. Në rast se studentit pasi të mbaron studimet në një program studimor, aplikon dhe regjistrohet në programin e ri studimor, atëherë në bazë të nenit 142 pika 5 e Statutit të UP-se, nuk mund të konsiderohet ndërrim programi.
2. Studenti me këtë rast obligohet që të ndjek ligjërata dhe të hyj në provime njëjtë sikurse studentët e tjerë.

#### **Neni 17**

1. Ç'regjistrimi i studentit apo tërheqja e dëftesave dhe diplomës origjinale mund të behet pas aprovimit të kërkesës nga sekretari i fakultetit.
2. Ç'regjistrimi mund të behet nga studentit personalisht apo personi tjetër me autorizim të noterizuar të studentit.

3. Dëftesa dhe diploma origjinale mund të tërhiqen më së shumti deri në 5 ditë pune, në rast të moskthimit të dokumentacionit sipas afatit të paraparë studentit ç'regjistrohet.

4. Me rastin e ç'regjistrimit studentit dorëzohet indeksin apo ID-kartelën e cila bëhet e pavlefshme me rastin e ç'regjistrimit, ndërsa me rastin e tërheqjes së dokumentacionit për një afat të caktuar studentit dorëzohet indeksin apo ID-kartelën deri në kthimin e dokumentacionit.

### **Vlerësimi dhe përcaktimi i suksesit akademik**

#### **Neni 18**

Përcaktimi i suksesit akademik dhe vlerësimi bëhet sipas Statutit të UP-së nenet 108 dhe 109.

#### **Neni 19**

Format, mënyrat, dinamikat dhe vlerësimet e provimeve bëhen sipas neneve 110 dhe 113 të Statutit të UP-së.

#### **Neni 20**

Në rast se studentit nuk është i kënaqur me rezultatin e provimit, ai në bazë të nenit 114 të Statutit të UP-së parashtron ankesë. Koha, mënyra e parashtrimit dhe trajtimit të ankesës janë përcaktuar me nenin 114 të Statutit të UP-së.

#### **Neni 21**

Të drejtën e riprovimit studentit e realizon në bazë të nenit 115 të Statutit të UP-së.

### **Përfundimi i studimeve**

#### **Neni 22**

1. Studimet bachelor në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit përfundojnë me përfundimin e punimit të diplomës në pajtim me programin e studimeve.

### **Thirrja e fituar me përfundimin e studimeve**

#### **Neni 23**

1. Me përfundimin e studimeve bachelor, studentit merr thirrjen Bachelor i Edukimit Fizik dhe Sportit, nëse ndryshe nuk përcaktohet me vendimin për Akreditim të programit të studimeve.

2. Deri në ditën e marrjes së diplomës studentit i lëshohet çertifikata e diplomimit e nënshkruar nga Dekani i Fakultetit.

## Neni 24

1. Suksesi i përgjithshëm i studentit në fund të studimeve përcaktohet me notën mesatare e cila paraqet mesataren përfundimtare të notave kaluese nga të gjitha provimet.
2. Me vendim të veçantë të Universitetit përcaktohet se çfarë duhet të përmbajë dosja e studentit të diplomuar para se t'i lëshohen certifikata e diplomimit dhe diploma.

## Përgjegjësia disiplinore

### Neni 25

Procedurat e marrjes së studentëve në përgjegjësi disiplinore përcaktohen me Statut dhe rregullore të veçantë.

## Dispozitat kalimtare

### Neni 26

1. Me propozimin e Këshillit të Fakultetit, kjo rregullore miratohet nga Senati i Universitetit të Prishtinës.
2. Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Ligjit Mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Senati i Universitetit të Prishtinës.
4. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen me procedurën e njëjtë me të cilën është miratuar.



Prof. Dr. Marjan Dema

Kryesues i Senatit, Rektor